



Republika e Kosovës/Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

-Kuvendi Komunal

01 Nr.06-4174/3

Dt.31.03.2015

D r a g a s h

Në bazë të nenit 12.2, shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/2008), nenit 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 i Ligjit 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtëshme të Komunës, si dhe nenit 32.2 të Statutit të Komunës-Dragash 01 Nr.06-103/1 të dt.11.09.2008, pas shqyrtimit paraprak të Kërkesës 01 Nr.351-2134 të dt.10.02.2015 NPN-SHPK "Renelual Tahiri"- Prizren, adresuar Kuvendit Komunal-Dragash, për dhënien e Pëlqimit për ndërtimin e hidro-centraleve të vogla në rrjedhën e lumenjëve: 1. Dragash-Ura e Rapçës dhe 2. Bellobrad-Kufiri me Shqipërinë(Lumi i Pllavës), Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.31.03.2015, miraton këtë:

V E N D I M

Për dhënien e Pëlqimit për ndërtimin e hidro-centraleve të vogla

- I. **JEPET PËLQIMI** për realizimin e investimeve për ndërtimin e hidro-centraleve të vogla në rrjedhën e lumenjëve: 1. Dragash-Ura e Rapçës dhe 2. Bellobrad-Kufiri me Shqipërinë (Lumi i Pllavës).
- II. Pëlqimi shërben si bazë për fillimin e procedurave për sigurimin e pëlqimeve dhe lejeve të nevojshme sipas dispozitave ligjore në fuqi për këtë lëmi, nga ministrinë përkatëse dhe Zyra Regullative e Energjisë.
- III. Ndërtimi i hidro-centraleve bëhet sipas Projektit të hartuar e në vendet e caktuara sipas Projekt-skicave.
- IV. Për zbatimin e këtij Vendimi përkujdeset kryetari i Komunës me Drejtoratin për Urbanizëm, Planifikim, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit-Dragash.
- V. Vendimi hynë në fuqi 15 ditë nga regjistrimi në protokolin e Zyrës së MAPL-it, si dhe publikimit në web-faqen e Komunës-Dragash.



I dërgohet:

- NPN – SHPK “Renelual Tahiri” - Prizren,
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (Zyrës Ligjore) - Prishtinë,
- Drejtoratit për Urbanizëm, Planifikim, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit-Dragash, dhe
- Arkivit



Kryesuesi i KK-së Dragash

Shaban Shabani,

Shaban Shabani